



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 11/17
Prishtinë, më 15.12.2017, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajqi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Mytaher Haskuka dhe Dardan Molliqaj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza - Ministër i Financave (tash e tutje Ministër), Salvador Elmazi - Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Gëzim Bislimi nga Departamenti i Buxhetit, dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetar i Komisionit (tash e tutje Kryetari).

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018:

1.1. Shqyrtimi i rekomandimeve të Grupeve Punuese të Komisionit për Buxhet dhe Financa

Kryetari - Ju faleminderit për punën që e keni bërë dy grupet punuese dhe besojë që është bërë një punë e madhe prej asaj që kemi pasur me grupin tonë besojë që ka qenë e njëjta edhe me grupin tjetër ku kemi trajtuar me korrektësi dhe me pajtueshmëri brenda grupit kërkesat.

Safete Hadërgjonaj – Ne me grupin punuese jemi takuar dy herë dhe të gjithë anëtarët e grupit kemi qenë shumë aktiv dhe kemi shqyrtuar një mori kërkesash dhe e falënderoj stafin që na ka ofruar sqarimet e nevojshme dhe na kanë përmbledhur të gjitha kërkesat. Ne kemi përkrah të gjitha ato kërkesat që kanë bëjnë me komunat, të cilat i kemi konsideruar se janë të arsyeshme dhe i rekomandojmë komisionit që ti miratojë ato.

Kryetari - Edhe ne e kemi mbajtur takimin si grup punues dhe brenda një dite i kemi trajtuar të gjitha kërkesat. Kërkesat që kanë ardhur prej agjencioneve të pavarura, pjesa më e madhe kanë qenë kërkesa për rritjen e pagave të agjencioneve dhe institucioneve të pavarura dhe ne e kemi arsyetuar para këtyre që na duhet një ligj i veçantë për pagat. Përfundimet e grupit punues për kërkesat e shqyrtuar, ato të

përkrahura dhe jo të përkrahura janë pjesë e materialit që kemi përpara. Përveç, kërkesave që janë rekomanduar të përkrahen, tek Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave propozimi është që të kthehet shuma e mallrave dhe shërbimeve siç e kanë kërkuar prej 9,956 euro, kështu që përveç këtij ndryshimi nuk ka asnjë gjë tjetër tjetër.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Komisioni lidhur me rekomandimet e grupeve punues për propozimin e ndryshimeve në Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, vendosi si në vijim:
 - 1.1. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për shtimin e 7 punëtorëve të rinj (1 Inspektor hetues të teknologjisë informative, 3 Inspektor hetues të konkurrencës dhe 3 Zyrtar të lartë të analizës së tregut), dhe shtimin e buxhetit shtesë në shumën prej 80,000.00 euro në kategorinë paga dhe mëditje, në Buxhetin e Autoritetit Kosovar i Konkurrencës për vitin 2018.
 - 1.2. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e Kërkesës Buxhetore të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve për vitin 2018.
 - 1.3. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e Kërkesës Buxhetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018.
 - 1.4. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen buxhetit shtesë në shumën prej 13,318.24 euro në kategorinë paga dhe mëditje, për Anëtarët e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin 2018.
 - 1.5. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e Kërkesës Buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2018.
 - 1.6. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për shtimin e 2 punëtorëve të rinj (2 zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional) dhe ndarjen e buxhetit shtesë në shumën prej 12,491.04 euro në kategorinë e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve, dhe shtimin e buxhetit shtesë tek kategoria e shpenzimeve mallrave e shërbimeve në shumë prej 9,956 euro, në Buxhetin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, për vitin 2018.
 - 1.7. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit shtesë prej 9,870.00 euro në kategorinë paga dhe mëditje për pozitën e Inspektorit të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, për vitin 2018. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e Kërkesës së Kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit për caktimin e një pagese fikse mujore, me arsyetimin se Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit ka planifikuar buxhetin por kompensimin e kryesuesit të Komisionit shqyrtues, në bazë të angazhimit sipas nevojës, siç parashihet me Ligjin nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.
 - 1.8. Komisioni miratoi rekomandimin e grupit punues lidhur me kërkesën e Autoritetit Rregullativ Hekurudhor për shtimin e 1 punëtori të rij, që është anëtar i bordit të Autoritetit në pajtim me Ligjin e ri të Hekurudhave të Kosovës. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e kërkesave të Autoritetit Rregullativ Hekurudhor për buxhet shtesë në kategoritë për paga dhe mëditje, për mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale, për vitin 2018.
 - 1.9. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e kërkesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për vitin 2018.
 - 1.10. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mos përkrahjen e kërkesave të Radio Televizionit të Kosovës për buxhet shtesë sipas nevojave reale. Buxheti i RTK-së mbetet siç është propozuar nga Qeveria në Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

- 1.11. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për shtimin e 1 punëtori (1 Udhëheqës të Divizionit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme) dhe buxhet shtesë për paga dhe mëditje në shumë prej 7,139.28 euro, me koeficienti 9, në buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2018.
- 1.12. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndryshimet në buxhetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, si në vijim: në programin Anëtarët e Kuvendit – kategoria mallrave dhe shërbimeve shtohet shuma prej 200,000€, programin Administrata e Kuvendit – shtohen 10 pozita të reja dhe kategoria paga dhe mëditje për 20 pozita në shumë prej 220,000€ (prej 20 pozitave 2 pozita miratohen në Njësinë Mbështetëse të Komisionin për Buxhet dhe Financa), si dhe miratohet kërkesa që mjetet e planifikuara prej 130,000 euro për shpenzime kapitale, transferohen në mallra dhe shërbime. Kërkesat shtesë për programin Stafi mbështetës Politik - kategoria paga dhe mëditje (14) pozita dhe mallrave dhe shërbimeve, mbetet të diskutohen në mbledhjen tjetër të komisionit.
- 1.13. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Organizatës Komunale të Pensionisteve dhe Invalidëve të Punës.
- 1.14. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë.
- 1.15. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Ndërmarrjes Publike Qendrore Posta e Kosovës.
- 1.16. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional për të Rritur (MASHT).
- 1.17. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues lidhur me kërkesën e Institutit Ndërkombëtar për Inteligjencë të Jashtëzakonshme për krijimin e një fondi të veçantë në kategorinë subvencione dhe transfere në buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në shumë prej 100,000.00 euro, për vitin 2018.
- 1.18. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e shumës prej 100,000 euro në buxhetin e Institutit të Historisë ‘Ali Hadri’ në Prishtinë, për vazhdimin e financimit të projektit shkencor.
- 1.19. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Akademisë së Shkencave dhe Arteve.
- 1.20. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.
- 1.21. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues lidhur me kërkesën Shërbimit Spitalor dhe Klinika Universitare i Kosovës për ndryshime në tabelat buxhetore brenda buxhetit të kësaj organizate buxhetore. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesës buxhetore të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitare të Kosovës për projektin “Ndërtimin e njësisë rehabilituese” në vlerë prej 238,912.25 euro.
- 1.22. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e shumës në buxhetin e Komunës së Vitisë prej 138,605.55 euro financimin e projektit ‘Renovimin i Shtëpisë së Kulturës në Viti’. Po ashtu Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunës së Vitisë për financimin e projektit ‘Rehabilitimin e Rugës Viti-Letnicë’ në shumë prej 100,000.00 euro. Ndërkaq, Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e Komunës së Vitisë për bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2019 dhe 2020 në vitin 2018 për Projektin “Ndërtimi i Stadiumit në Viti” dhe kërkesën për buxhet shtesë për Projektin “Palestra sportive në Viti” në shumë prej 568,997.08 euro.
- 1.23. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndryshimet në buxhetin e Komunës së Lipjanit si në vijim: Në Ministrinë e Infrastrukturës shtohet projekti “Ruga rreth hekurudhës, prej udhëkryqit Glllogvc - Rubovc deri te stadioni i qytetit Lipjan”. Në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë emërtimi i projektit “Ndërtimi i Sallës se sportive në shkollën fillore Shalë në Lipjan” të ndryshohet ne emërimin “Ndërtimi i Sallës se sportive në shkollën

fillore Sillovi në Lipjan. Komisioni po ashtu miratoi rekomandimin lidhur me kërkesën e Komunës së Lipjanit për projektin e ri ‘Ndërtimi i Shtratit të Lumit Sitnica dhe ndërtimi i kolektorit të ujërave të zezave rreth shtratit të Lumit Sitnica, si në vijim: për vitin 2018 ndahet shuma prej 400,000 euro për vitin 2019 ndahet shuma 400,000 euro dhe për vitin 2020 shuma 400,000 euro. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesave tjera të Komunës së Lipjanit.

- 1.24. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues lidhur me kërkesën Komunës së Obiliqit për ndarjen e buxhetit për projektin ‘Ndërtimin e Sheshit’ në shuma si në vijim: ndahen 300,000 euro në vitin 2018, 300,000 euro në vitin 2019 dhe 300,000 euro në vitin 2020. Komisioni po ashtu miratoi rekomandimin e Grupit Punues lidhur me ndarjen e buxhetit për financimin e projektit ‘Ndërtimi dhe rregullimi i kanalizimit, në Breznicë-Kozaricë’, dhe atë 100,000 euro në vitin 2018 dhe 100,000 euro në vitin 2019. Si dhe ndarjen e buxhetit për financimin e projektit ‘Ndërtimi i rrugëve, në Lagjen Hade e Re’ dhe atë 300,000 euro në vitin 2018, 200,000 euro në vitin 2019 dhe 200,000 euro në vitin 2020. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesave tjera të Komunës së Obiliqit.
- 1.25. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për shtimin e 7 punëtorëve të rinj (2 Mjek, 3 Teknik medicinal, 1 Vozitës të autoambulancës dhe 1 Mirëmbajtës te objekti te QKMF), në buxhetin e Komunës së Junikut.
- 1.26. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunën e Gjilanit për financimin e “projektit të Lumit Mirusha”, me shumatat si në vijim: ndahen 400,000 euro në vitin 2018 dhe 400,000 euro në vitin 2019.
- 1.27. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunën e Shtërpçës për financimin e projektit ‘Rregullimi i rrugës në mëhallën Bandulline-vendbanimi Brezovicë’, në shumë prej 130,851.00 euro. Ndërkaq, miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesave tjera të Komunës së Shtërpçës.
- 1.28. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunën e Fushë Kosovës për financimin e projektit ‘Ndërtimin e Palestrës Sportive në Komunën e Fushë Kosovës’ dhe atë si në vijim: ndahen 300,000 euro për vitin 2019 dhe 300,000 euro për vitin 2020. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për mospërkrahjen e kërkesave tjera të Komunës së Fushë Kosovës.
- 1.29. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunën e Podujevës për financimin e projekteve në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës si në vijim: Projekti me kod 15276 – “Ndërtimi i rrugës Shajkoc-Xehërore” shtohet buxheti në shumë prej 150,000 euro, Projekti me kod 15277 – “Ndërtimi i rrugës Pakashticë – Çenogë” shtohet buxhet në shumë prej 50,000 euro, Projekti me kod 14540 – Asfaltimi i rrugës Ballaban – Orllan (te Liqeni i Batllavës) shtohet buxhet në shumë prej 187,958 euro dhe Projekti me kod 14762 – Asfaltimi i rrugëve në Podujevë (rruga e Xhamisë) 100,000 euro.
- 1.30. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për miratimin e kërkesave të Komunës së Istogut, si në vijim: Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovë, shtohet Projekti “Memoriali Ibrahim Rugova”, dhe buxheti në shumë prej 200,000 euro. Në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor te programi me bashkëfinancim me komuna për Projektin “Ndërtimi i parkut të qytetit në Istog” në lokacionin e ish ndërmarrjes publike Radusha, shtohet buxhet në shumë prej 150,000 euro.
- 1.31. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues për ndarjen e buxhetit në Komunën e Kaçanikut si në vijim: Në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për projektin “Ndërtimi i Objektit për Banim Social” shtohet buxhet në shumë prej 190,378.77 euro, si dhe shtohet projekti Asfaltimi i rrugës “Mujedin Aliu” në shumë prej 100,000 euro.
- 1.32. Komisioni miratoi rekomandimin e Grupit Punues lidhur me kërkesën e Deputetes Jelena Bontic për shtimin e projektit të ri “Asfaltimi i rrugës Brace Matovica (tregti MK) në fshatin

Leshak, Komuna Leposaviq”, në shumë prej 30,000 euro, në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës.

- 1.33. Komisioni miratoi propozimin e deputetes Safete Hadërgjonaj për financimin e Projektit të ri “Bazamenti i shtatores Edmond Hoxha, në Junik”, në shumë prej 50,000 euro, në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

1.2. Shqyrtimi i Amendamentit të propozuar nga deputetët Hajdar Beqa dhe Teuta Haxhiu

Kryetari – Amendamenti i propozuar nga deputetët, ka të bëjë me ndarjen e mjeteve shtesë për ndërtimin e ujësjellësit të infrastrukturës së ujit për 28 fshatrat të komunës së Gjakovës.

Ministri - Tek projekti i këtij amendamenti Ministria e Financave e konsideron si amendament jo i propozuar mirë por mbi të gjitha tek ne është shuma që po flasim për një projekt të rëndësishëm dhe propozojmë që për këtë projekt të ndahen 200.000 euro.

Pas sqarimeve dhe në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Përfundimi i punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra të Komunës të Gjakovës”, në shumë prej 200,000 euro. Amendamenti i propozuara nga deputetët Hajdar Beqa dhe Teuta Haxhiu, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.1. Shqyrtimi i Amendamentit të propozuar nga Deputeti Hajdar Beqa

Kryetari – amendamenti parasheh që për projektin “Asfaltimi i rrugës Molliq-Botush” të parashihet vlera 150.000 euro në buxhetin e vitit 2018 dhe këto mjete të merren nga Ministria e Infrastrukturës.

Ministri - nuk e mbështesim amendamentin.

Pas sqarimeve dhe në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu amendamentin e propozuar nga Deputeti Hajdar Beqa.

1.2.2. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Evgjeni Thaçi-Dragusha

Kryetari – amendamenti parasheh që në organizatën buxhetore Ministria e Mjedisit dhe Zhvillimit Hapësinor, të ndahen 200,000 euro për projektin e ri ‘kyçet individuale në ujësjellës për 12 fshatrat e Komunës së Skenderajit’

Ministri - e mbështesim amendamentin.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore”, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Kyçet individuale në ujësjellës për 12 fshatra të Komunës së Skenderajt”, në shumën prej 200,000 euro. Amendamenti i deputetes Evgjeni Thaçi-Dragusha, rekomandohet të tërhiqet, për shkak të natyrës jo të mirë teknike të hartimit të tij, duhet të tërhiqet.

1.2.3. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Blerta Deliu-Kodra

Kryetari – amendamenti i deputetes Blerta, parasheh që në organizatën buxhetore ‘Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit’ me kod organizativ 207, në tabelën 3.1, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, shtohet shuma prej 600,000 euro.

Ministri - nuk e mbështesim amendamentin.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu amendamentin e propozuar nga deputetja Blerta Deliu-Kodra.

1.2.4. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Daut Haradinaj

Kryetari – deputeti kërkon të ndahen 100,000 euro për vendosjen e ujësjellësit për fshatin Rimanishtë, Komuna e Prishtinës.

Ministri - nuk e mbështesim amendamentin.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Rimanishtë, Prishtinë”, në shumën prej 100,000 euro. Amendamenti i deputetit Daut Haradinaj, rekomandohet të tërhiqet, pasi që nuk është hartuar mirë teknikisht.

1.2.5. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetëve Teuta Haxhiu dhe Hajdar Beqa

Kryetari - amendamenti në fjalë parasheh që për projektin “Asfaltimi i rrugës Smolicë, Stubëll-Berjahë-Nivokaz-Junik, të ndahen mjete në vlerë prej 200,000 euro për vitin 2018, dhe projekti në total arrin shifrën 950,000 euro.

Ministri - është një rrugë që ka shumë rëndësi nuk është kërkesë që nuk mund të akomodohet në vitet vijuese, por mendoj që vitin e ardhshëm me financu 150,000 euro dhe pjesën tjetër nëpër vitet vijuese.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës Smolicë-Stubëll-Berjahë-Nivokazë, Junik”, në shumë prej 150,000 euro. Amendamenti i propozuara nga Deputetët Teuta Haxhiu dhe Hajdar Beqa, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.6. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj

Kryetari - deputetja kërkon që në buxhetin e vitit 2018 të financohet Projekti “NDËRTIMI I GYPSJELLËSIT” për rrugën ‘Janina dhe Nënë Tereza’ në PRIZREN. Shuma e projektit është 205,681,28 euro.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Përkrahet amendamenti i deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj, që në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i Gypsjellësit, për rrugën “Janina dhe Nënë Tereza”, Prizren”, në shumën prej 205,682 euro.

1.2.7. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Doruntinë Maloku

Kryetari – amendamenti i deputetes Maloku, parasheh që projekti i financuar nga Ministria e Administratës Publike, me kod 14301 Ndërtimi i SHFMU në fshatin Bajçinë-kontrata për realizimin e projektit është tri vjeçare bazuar në buxhetin e vitit 2017-2019, kurse sipas projekt buxhetit 2018-2020, i njëjti kalon në periudhën të realizimit katër vjeçare dhe nuk ka siguri të realizimit për arsye se mungojnë mjete në shumën prej 199,566,26 euro.

Ministri - propozojë që shumat të vendosen në vitin 2020.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni përkrahu kërkesën që shuma prej 199,566.26 euro për projektin “Ndërtimi i SHFMU në fshatin Bajçinë, Podujevë, të kalojë në vitin 2020. Amendamenti i propozuara nga deputetja Doruntinë Maloku, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.8. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Arbërie Nagavci

Kryetari – deputetja Nagavci, ka kërkuar që në organizatën buxhetore ‘Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë’, (kodi 208) të shtohet edhe një nën program në fund të tabelës së kësaj organizate për pagesën e pagës jubilarë dhe tre pagave përcjellëse pas pensionimit, sipas Nenit 35 (pika 8 dhe 9) e kontratës kolektive të arsimit të Kosovës. Shuma e përgjithshme është paraparë 908,946.00 euro në nivel vendi.

Ministri - Të gjitha obligimet ligjore që i kanë organizatat buxhetore qendrore dhe lokale kanë të ndarë buxhet.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Arbërie Nagavci.

1.2.9. Shqyrtimi i amendamenteve të Grupit Parlamentar 6+

Ministri - ne kemi biseduar me Grupin 6+ dhe ne do ta gjejmë një zgjidhje gjithësisë, mirëpo deputet Damka ne kemi trajtuar të gjitha ministrinë e linjës dhe të gjitha organizatat buxhetore vjet. Nëse një organizate buxhetore iu kemi dhënë autonomi në shfrytëzimin e buxhetit me procedura të rregullta nuk kemi mundur me vendos një organizatë tjetër buxhetore të një ministrie të linjës restriksione me nene të caktume edhe me vendos pabarazi. Andaj neni 12 nuk është në vitin 2018 sepse siguron pabarazi mes organizatave buxhetore. Unë besojë që Ministria për Komunitete dhe Kthim do ta shpenzon buxhetin në përputhje për legjislacionin në mënyrë më korrekte.

Fikrim Damka - Ne këtë çështje e kemi biseduar disa vite dhe buxhetin e ndarë për projektet për komunitet në Ministrinë e Komuniteteve për Kthim, gjithmonë e kemi paraqitur edhe me fakte që komunitetet tjera jo serbe nuk e kanë marrur hisen prej Ministrisë e cila i takon me nen. Po shohim që 10 vite e radhës edhe në këtë Ministri nuk ka projekte konkrete për secilin komunitet dhe kjo ka qenë arsyeja që ne e kemi ndarë dhe të kemi qasje në këto projekte, ne i kemi projektet që mundemi mi paraqit në Ministri. Ne për këtë punë kemi kërkuar që ta ndajmë këtë çështjen në vitin 2016-2017 dhe kemi gjetur një formulë dhe e kemi cekur që të ketë një program ku Qeveria e aprovon në Janar këto projekte për këto dy çështje dhe e kemi parë që nuk ka funksionuar.

Ministri – propozimi ynë është që në projektin për komunitet në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale shuma e paraparë prej 1,000,000 euro të rritet në 1,800,000 euro për komunitetet jo shumicë.

Fikrim Damka – po ashtu kërkojmë që për projektin e Qendrës Rinore në Mamushë shuma prej 150,000 euro, që është planifikuar të realizohet në vitin 2020 të bartet në vitin 2018. Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni propozoi që në buxhetin e Ministrisë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në nën-programin “Institucionet”, me kod 00700, në tabelën 3.2., Projekti me kod 15750 “Projekti mbështetje për komunitete”, në shumë prej 1,000,000 euro, ndryshohet në emërtimin e ri “Projekti mbështetje për komunitetet tjera jo shumicë”, në shumë prej 1,800,000 euro. Po ashtu në Buxhetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në nën-programin “Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë”, në tabelën 3.2., me kod 80700, në Projektin me kod 15621 “Qendra Rinore në Mamushë”, shuma prej 150,000 euro e paraparë në vitin 2020, bartet në vitin 2018. Komisioni rekomandon tërheqjen e amendamentit 1,2 dhe 5 të propozuara nga Grupi Parlamentar 6+.

1.2.10. Shqyrtimi i 4 amendamenteve të Deputetit Bekim Haxhiu

Kryetari – kryetari sqaroi përmbajtjen e 4 amendamenteve të deputetit Bekim Haxhiu.

Ministri – theksoi se përkrahim amendamentet e propozuara nga deputetit Haxhiu. Por që ato të shndërrohen në amendamente të komisionit, pasi që është përmendur shuma ku merren mjetet. Ne do të propozojmë se ku të merren mjetet për të mbuluar këto ndarje të reja.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Rregullimi i Lumit Klina nga fshati Kuqicë deri në Skenderaj”, në shumën prej 200,000 euro.
2. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., në projektin me kod 15665 “Ndërtimi i tribunave, rrethojë dhe shtrimi i zhavorit në Stadiumin e futbollit në Runik, Skenderaj”, shuma prej 100,000 euro, ndryshohet në shumën 200,000 euro.
3. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Mbrotjtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”, me kod 81500, në tabelën 3.2., shtohet Projekti “Restaurimi i Akademisë së parë ushtarake të UÇK-së në Açarevë, Skenderaj”, me shumë prej 40,000 euro.
4. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Mbrotjtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”, me kod 81500, në tabelën 3.2., shtohet Projekti “Ndërtimi i Kullës të Shaban Manxhollit në fshatin Mikushnicë, Skenderaj”, me shumë prej 40,000 euro.
5. Komisioni kërkon nga deputeti tërheqjen e 4 amendamenteve, për shkak se burimi i mjeteve për të mbuluar ndarjet buxhetore do të propozohet nga Ministria e Financave dhe do të përfshihet në raportin me amendamente të komisionit për shqyrtim në lexim të dytë.

1.2.11. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Ahmet Isufi

Kryetari – deputeti Isufi në amendamentin e propozuar ka potencuar se në Projektligjin për Buxhetin për vitin 2018, me kod 14039, është paraparë ndërtimin dhe renovimin i infrastrukturës së Universitetit të Gjilanit dhe ka kërkuar që emërtimi të ndërrohet dhe të formulohet si vijon ‘Projekti ideor i ndërtimit dhe renovimi infrastrukturës për Kampusin e Universitetit të Gjilanit Kadri Zeka’.

Ministri – e mbështesim amendamentin, por për shkaqe teknike të emërtimit të projektit të vendoset si amendament i komisionit dhe deputeti të tërheq amendamentin.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Universiteti i Gjilanit”, në tabelën 3.2. me kod 97700, emërtimi i Projektit me kod 14039 “Ndërtimi dhe renovimi i Infrastrukturës së Universitetit të Gjilanit”, në shumë prej 250,000 euro, ndryshohet në emërtimin e ri “Ndërtimi i Kampusit të Universitetit Kadri Zeka, Gjilan”, në shumë prej 450,000, për vitin 2018. Komisioni rekomandon që deputeti Ahmet Isufi të tërheq amendamentin, pasi që nuk është hartuar mirë teknikisht.

1.2.12. Shqyrtimi i 2 amendamenteve të Deputetit Rasim Selmanaj

Kryetari – në amendamentin e parë, deputeti Selmanaj, ka kërkuar që për Rrugën Deçan-Plavë, nga 2.4 milionë për vitin 2018 të ndahen 10 milionë ose të paktën 5 milionë për vitin 2018, ndërsa për vitin 2019

të parashihen mjete për përfundimin e këtij projekti. Në amendamentin e dytë është theksuar se për palestrës sportive në Deçan 2017-2020, janë paraparë 50,000 mijë euro, projekti ka nisur në vitin 2009, ndërsa duhen 600,000 mijë euro, të përfundojë projekti dhe kërkohet të ndahen mjetet për vitin 2018.

Ministri - ministria e financave propozon që për këtë projekt të ndahen 250,000 euro.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., në Projektin me kod 11007 “Palestra e Sportit-Deçan” shuma prej 50,000 euro, ndryshohet në shumën 300,000 euro. Komisioni rekomandon tërheqjen e amendamentit të propozuar nga deputetit Rasim Selmanaj.
2. Komisioni nuk përkrahu amendamentin për ndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e Rrugës Deçan-Plavë.

1.2.13. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Imet Rrahmani

Kryetari – amendamenti i deputetit Rrahmani parasheh që në Organizatën buxhetore ‘Ministria e Shëndetësisë’, bëhen ndryshime si në vijim: Projekti ‘Ndërtimi i Ndërtesës së QKMF, Gjilan’, me kod 14544, në tab.3.2, Projekte Kapitale në Nivel Qendror, shuma 337,000 euro, ndryshohet në 500,000 euro.

Ministri – përkrahim amendamentin.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni përkrahu amendamentin e deputetit Imet Rrahmani që në Organizatën buxhetore ‘Ministria e Shëndetësisë’ bëhen ndryshime si në vijim: Projekti ‘Ndërtimi i Ndërtesës së QKMF, Gjilan’ me kod 14544, në tab.3.2, Projekte Kapitale në Nivel Qendror, shuma 337,000 euro, ndryshohet në 500,000.

1.2.14. Shqyrtimi i 13 amendamenteve të Deputetit Avdullah Hoti

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga deputeti Avdullah Hoti.

Ministri – theksoi se mbështesim amendamentet e propozuara nga deputeti Hoti, por të vendosen si amendamente të komisionit, për shkak se si ministri do të propozojmë mjetet për mbulimin e këtyre projekteve.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Investimet kapitale në arsimin

- parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Fasadimi i shkollës fillore “Aziz Sylejmani”, në Mitrovicë”, në shumë prej 10,000 euro.
2. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë”, në shumë prej 400,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohet shuma 200,000 euro dhe në vitin 2020 shtohet shuma 200,000 euro.
 3. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i sallës së edukatës fizike dhe rregullimi i oborrit në shkollën e Mesme të Lartë në Ratkoc-Rahovec”, në shumë prej 100,000 euro për vitin 2018, dhe në vitin 2019 shtohet shuma 300,000 euro.
 4. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës Sami Frashëri, në gjatësi prej 300 metra, në Mitrovicën Veriore”, në shumë prej 40,000 euro.
 5. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, në Projektin me kod 14744 “Ndërtimi i udhëkryqit në fshatin Xërxë dhe Krushë e Madhe” shuma 64,431 euro ndryshohet në shumën 268,000 euro.
 6. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës Tirana, në Mitrovicën Veriore”, në shumën prej 50,000 euro.
 7. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Mbrotjtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”, në tabelën 3.2., me kod 81500, shtohet Projekti, shtohet projekti i ri “Renovimi i Galerisë së Arteve në Kullën e Ali Kadriut në Kroin e Vitakut, në Mitrovicë”, në shumë prej 20,000 euro.
 8. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., në projektin me kod 14559 “Ndërtimi Palestra e Sportit - Krushë e Madhe, Rahovec”, shuma prej 100,000 euro, ndryshohet në shumën 250,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019, shuma 300,000 euro bëhet 400,000 euro dhe në vitin 2020, shuma 100,000 euro ndryshohet në 400,000 euro.
 9. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim:Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., në projektin me kod 10464 “Palestra e Sporti - Rahovec”, shuma prej 100,000 euro, ndryshohet në shumën 270,000 euro. Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., në projektin me kod 15354 “Rregullimi i stadiumit të futbollit në Ratkoc-Rahovec”, shuma prej 100,000 euro, ndryshohet në shumën 250,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019, shuma 150,000 euro bëhet 250,000 euro.
 10. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, me kod organizativ 209, bëhen ndryshimet si në vijim: Shtohet projekti i ri me titull “Ndërtimi i kulmeve në 3 shtëpi në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicë”, në shumë prej 15,000 euro.
 11. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, me kod organizativ 209, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Institucionet”, me kod 00700, në tabelën 3.2., shtohet projekti i ri me titull “Ndërtimi i 10 shtëpive për çdo vit në Lagjen Kroi i Vitakut” në Mitrovicë , me shumat si në vijim: për 2018 vlera 100,000, për 2019 vlera 100,000 dhe për 2020 vlera 100,000 euro.

12. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, me kod organizativ 209, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Institucionet”, me kod 00700, në tabelën 3.2., shtohet projekti i ri me titull “Ndërtimi i dy shtëpive në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë”, në shumë prej 30,000 euro.
13. Komisioni rekomandon që deputeti Avdullah Hotit, të tërheq 13 amendamentet pasi që burimin e mjeteve për financimin e këtyre projekteve do ta propozojë Ministria e Financave dhe do të jetë pjesë e raportit me amendamente që do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

1.2.15. Shqyrtimi i 4 amendamenteve të Deputetes Time Kadriaj

Kryetari – lexoi katër amendamentet e propozuara nga deputetja Time Kadriaj.

Ministri – theksojë se mbështesim projektin për ndarjen e mjeteve për projektin ri “Projekti shkolla fillore “Kuvendi i Verrave të Llukës”, në shumë prej 100,000 euro. Si dhe amendamentin që të bëhet lëvizja brenda programit me kod 420 bashkëfinancim me Kuvendet Komunale dhe nga projekti me numër 14216 “Asfaltimi i rrugës “Dol Kusar Goden” të hiqen 100 mijë euro dhe të kalojnë në projektin me kod 15365 “asfaltimi i rrugës nacionale “Manastir – Hidrocentrali Lumbardh, Deçan”.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2., me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Projekti shkolla fillore “Kuvendi i Verrave të Llukës”, në shumë prej 100,000 euro. Amendamenti i propozuar nga deputetja të tërhiqet për shkak të hartimit jo të mirë në aspektin teknik. Komisioni rekomandoi tërheqjen e amendamentit të propozuara nga deputetja Time Kadriaj, për këtë çështje.
2. Komisioni përkrah amendamentin për lëvizje brenda për brenda programit me kod 420 bashkëfinancim me Kuvendet Komunale dhe nga projekti me numër 14216 “Asfaltimi i rrugës “Dol Kusar Goden” të hiqen 100 mijë euro dhe të kalojnë në projektin me kod 15365 “asfaltimi i rrugës nacionale “Manastir – Hidrocentrali Lumbardh, Deçan”. Komisioni rekomandoi tërheqjen e amendamentit të propozuara nga deputetja Time Kadriaj, për këtë çështje.
3. Komisioni nuk përkrah amendamentin që në projektligjin për buxhetin e vitit 2018, në tabelën e projekteve kapitale, për komuna të shtohet një projekt i ri në komunën e Deçanit “Zgjerimi i Qendrës së qytetit nga Ura e Demës – Carrabreg”.
4. Komisioni nuk përkrah amendamentin që në projektligjin për buxhetin për vitin 2018, në tabelën e projekteve kapitale për komuna të shtohet edhe një projekt i ri për komunën e Deçanit “Asfaltimi i rrugëve Strellci epërm Dranoc, Gramaqel, Restovic” të parashihen për vitin 2018, 200 mijë euro.

1.2.16. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Saranda Bogujevci

Kryetari – deputetja Bogujevci në amendamentin e saj ka propozuar që në tabelën 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2018-2020, te kodi buxhetor nr.46064, me emrin Ujësjiellësi në Orllan, shumës së ndarë prej 50,000 euro të rritet në shumën prej 500,000 për vitin 2018.

Ministri – propozojmë që për vitin 2018 për këtë projekt të jetë shuma prej 200,000 euro. Pjesa tjetër të ndahet për vitet tjera.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet projekti i ri “Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Orllan, Podujevë”, në shumë prej 50,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohen shuma 300,000 euro. Komisioni rekomandoi tërheqjen e amendamentit të propozuara nga deputetja Saranda Bogujevci.

1.2.17. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Anton Quni

Kryetari – deputeti Çuni ka kërkuar që për projektin Ngritja e shtatores së Profesor Anotn Çeta, Kryetar i Këshillit Qendror të Lëvizjes Kombëtare për Pajtimin e Gjakeve, të ndahet shuma prej 70,000 euro, dhe të sigurohen nga organizata buxhetore me kod 11078.

Ministri – mbështesin amendamentin dhe të shndërrohet si amendament i komisionit për shkaqe teknike të hartimit të tij.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Nën-programi “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës”, me kod 27900, në tabelën 3.2 shtohet Projekti i ri “Ngritja e shtatores së Anton Çetës, në Prishtinë”, në shumë prej 70,000 euro.
2. Komisioni rekomandon që deputeti Anton Quni të tërheq amendamentin për shkak të hartimit jo të mirë në aspektin teknik.

1.2.17. Shqyrtimi i 5 amendamenteve të Deputetes Mimoza Kusari - Lila

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga deputetja Kusari-Lila dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Shëndetësisë”, me kod organizativ 206, në tabelën 3.2., bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Zhvillimi i resurseve njerëzore në KPSH”, me kod 71000, projekti me kod 15097 “Ndërtimi i ndërtesës QKMF, Gjakovë”, shuma prej 313,000 euro, ndryshohet në shumën 413,000 euro. Amendamenti i deputetit Mimoza Kusari Lila, rekomandohet të tërhiqet.
2. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Përkrahje Institucionale për Kulturën”, me kod 80300, në tabelën 3.2., në Projektin me kod 14803 “Qendra e Kulturës në Rugovë të Hasit”, shuma prej 200,000 euro, ndryshohet në 500,000 euro në vitin 2018. Si dhe në vitin 2019, shuma prej 300,000 euro ndryshohet në shumën 700,000 euro. Amendamenti i deputetit Mimoza Kusari Lila, rekomandohet të tërhiqet.
3. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Administratës Publike”, me kod organizativ 202, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programin “Departamenti i Standardeve dhe Politikave IMNQ”, me kod 12300, në tabelën 3.2., në projektin me kod 14971, “Ndërtimi i shkollës fillore Ponoshec

(Korenicë), Gjakovë”, shuma 100,000 euro, ndryshohet në shumën 283,000 euro. Amendamenti i deputetit Mimoza Kusari Lila, rekomandohet të tërhiqet.

4. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në Organizatën Buxhetore me kod 0810, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në kategorinë për investime kapitale projekti me kod 14225 Ndërtimi i kompleksit të tenisit në komunën e Gjakovës vlera 100,000 euro ti shtohen 388,979 euro nga kodi buxhetor 11708 Ndërtimi i Ambasadave jashtë vendit.
5. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në Organizatën Buxhetore me kod 0443 ,Ministria e Infrastrukturës, në kategorinë për investime kapitale projekti me kod 15659 Ndërtimi i qarkores së Gjakovës, në komunën e Gjakovës vlera 3,000,000euro ti shtohen për vitin 2018 edhe 2,000,000 nga kodi buxhetor 15658 Ndërtimi rrugës Dollc – Gjakovë.

1.2.18. Shqyrtimi i 9 amendamenteve të deputetit Enver Hoti

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga deputeti Hoti, pas arsyetimit të amendamenteve nga deputeti Enver Hoti dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet projekti i ri “Projekti Kanalizimi në fshatrat Lladrovç-Carrallukë-Malishevë”, në shumë prej 200,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti për këtë çështje, rekomandohet të tërhiqet.
2. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet projekti i ri “Rregullimi i shtratit të Lumit Mirusha, Malishevë”, në shumë prej 300,000 euro për vitin 2018 dhe në vitin 2019 shtohen 200,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti, për këtë çështje rekomandohet të tërhiqet.
3. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Arritjet Sportive”, me kod 80200, në tabelën 3.2., shtohet projekti i ri “Salla e Sportit Drenoc, Malishevë”, në shumë prej 200,000 euro për vitin 2018. Amendamenti i deputetit Enver Hoti për këtë çështje, rekomandohet të tërhiqet.
4. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore “Ibrahim Mazreku” në Malishevë” në shumë prej 300,000 euro për vitin 2018 dhe në vitin 2019 shtohet shuma prej 200,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti për këtë çështje, rekomandohet të tërhiqet.
5. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale”, me kod organizativ 209, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Institucionet”, me kod 00700, në tabelën 3.2., shtohet Projekti “Ndërtimi i qendrës për banim social në Malishevë” në shumë 150,000 euro në vitin 2018 dhe në vitin 2019 shtohet shuma 150,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti për këtë çështje, rekomandohet të tërhiqet.
6. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i tranzitit në linjën Carrallukë-Klinë, Pllankë-Dragobil” në shumë prej 600,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohen 600,000 euro dhe në vitin 2020 shtohen 800,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti për këtë çështje, rekomandohet të tërhiqet.

7. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në projektligjin për buxhetin e vitit 2018, në tabelën e projekteve kapitale për komuna të shtohet një projekt i ri në komunën e Malishevës. ``Ndertimi i sistemi të ujitjes në fshatrat Banjë– Bubël të Mlishevës.``Për këtë projekt nevoiten 500,000.00 euro. Mjetet të sigurohen nga: MBPZHR-ja (Ndërtimi dhe rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë).
8. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në projektligjin për buxhetin e vitit 2018, në tabelën e projekteve kapitale për komuna të shtohet një projekt i ri në komunën e Malishevës. ``Kanalizimi nga fshatrat :Mleqanë - Kjevë- Bubël``. Për këtë projekt nevoiten 500,00.00 euro. Mjetet për këtë projekt të sigurohen nga Ministria e Pushtetit Lokal.
9. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në projektligjin për buxhetin e vitit 2018, në tabelën e projekteve kapitale për komuna të shtohet një projekt i ri në komunën e Malishevës. ``Ndertimi i çerdhes së fëmijëve në Malishevë.``

1.2.19. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Lutfi Zharku

Kryetari – deputeti Zharku ka propozuar që në Organizatën buxhetore ‘Ministria e Infrastrukturës’, me kod organizativ 205, bëhet ndryshimet si në vijim: Nënprogrami-‘Ndërtimi i autostradave’ me kod 42200, në tabelën 3.2, në kategorinë ‘shpenzime kapitale’ të shtohet projekti me kod të ri buxhetor ‘Ndërtimi i kyçeve të reja për Ferizaj dhe Viti në autostradën Prishtinë-Hani i Elezit (R6)’ shuma prej 10 mil euro. Si dhe në pikën e dytë në nënprogrami-‘Departamenti i transportit tokësor’ me kod 45900, në tabelën 3.2, në kategorinë ‘shpenzime kapitale’ të shtohet projekti me kod të ri buxhetor (15096) ‘Studimi i fisibilitetit për kalimin nëntokësor të hekurudhës në Ferizaj’, shuma prej 300,000.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu amendamentin e propozuar nga deputeti Lutfi Zharku.

1.2.20. Shqyrtimi i 2 amendamenteve të Deputetit Blerim Kuqi

Kryetari - lexoi amendamentet e propozuara nga deputeti Kuqi, pas arsyetimit të amendamenteve nga deputeti Blerim Kuqi dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shtrati Toplluha, në qytetin e Suharekës”, në shumën prej 200,000 euro në vitin 2018. Si dhe në vitin 2019, shtohet shuma prej 300,000 euro. Deputeti Blerim Kuqi, ka tërhequr amendamentin e propozuar.
2. Në Organizatën buxhetore “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës”, me kod organizativ 253, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës”, me kod 27900, në tabelën 3.2 shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i memorialit të Berishëve, në qytetin e Suharekës”, në shumë prej 300,000 euro. Deputeti Blerim Kuqi, ka tërhequr amendamentin e propozuar.

1.2.21. Shqyrtimi i 2 amendamenteve të Deputetit Nezir Çoçaj

Kryetari – lexoi dy amendamentet e propozuara nga deputeti Nezir Çoçaj.

Ministri – ne mbështesin propozimin që për projektin “Asfaltimi i rrugës Mazrek-Xhonaj-Bishatazhin, Prizren”, shuma prej 50,000 euro, ndryshohet në shumën 350,000 euro. Po ashtu në vitin 2019 shtohet shuma prej 150,000 euro. Ndërkaq, amendamentin tjerë për ndarjen e shumës për paga dhe mëditje në shumën 60,000.00 për stafin profesional në Institutin Pedagogjik të Kosovës, nuk e mbështesim, pasi që çështja e pagave duhet të rregullohet me ligjin për paga.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100,, në projektin me kod 15368, “Asfaltimi i rrugës Mazrek-Xhonaj-Bishatazhin, Prizren”, shuma prej 50,000 euro, ndryshohet në shumën 350,000 euro. Po ashtu në vitin 2019 shtohet shuma prej 150,000 euro. Amendamenti i deputetit Nezir Çoçaj, rekomandohet të tërhiqet.
2. Komisioni nuk përkrahu amendamentin që në MASHT, të rritet buxheti për paga dhe mëditje në shumën 60,000.00 për stafin profesional në Institutin Pedagogjik të Kosovës.

1.2.22. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetit Islam Pacolli

Kryetari – amendamenti i deputetit Pacolli, parasheh që në organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, emërtimi i Projektit me kod 15298 “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Veternikut deri të udhëkryqi fshati Amerikan” ndryshohet në emërtimin e ri “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Veternikut deri në hyrje të Graçanicës”, si dhe shuma në vitin 2018, prej 300,000 euro ndryshohet në 700,000 euro, shuma prej 400,000 euro në vitin 2019 ndryshohet në shumën 1,000,000 euro dhe shuma prej 0 (zero) ndryshohet në 500,000 euro në vitin 2020.

Ministri – është një projekt i rëndësishëm, që përfshinë edhe shpronësime, prandaj realizimi i tij do të bëhet nëpër vite. Propozojmë që për vitin 2018 të ndahen 400,000 euro, për vitin 2019, të ndahen 600,000 euro dhe për vitin 2020, të ndahen 500,000 euro.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, emërtimi i Projektit me kod 15298 “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Veternikut deri të udhëkryqi fshati Amerikan” ndryshohet në emërtimin e ri “Zgjerimi i rrugës nga Ura e Veternikut deri në hyrje të Graçanicës”, si dhe shuma në vitin 2018, prej 300,000 euro ndryshohet në 700,000 euro, shuma prej 400,000 euro në vitin 2019 ndryshohet në shumën 1,000,000 euro dhe shuma prej 0 (zero) ndryshohet në 500,000 euro në vitin 2020. Amendamenti i deputetit Islam Pacolli, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.23. Shqyrtimi i amendamentit të Deputetes Hykmete Bajrami

Kryetari – deputetja Bajrami ka propozuar nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2., me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore në Sferkë, Pejë”, në shumë prej 124,178 euro.

Ministri – mbështesim amendamentin, por për shkaqe teknike të hartimit të tyre, duhet të shëndrrohet si amendament i komisionit.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2., me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore në Sferkë, Pejë”, në shumë prej 124,178 euro. Amendamenti i deputetes Hykmete Bajrami rekomandohet të tërhiqet për shkak të hartimit jo të mirë në aspektin teknik.

1.2.24. Shqyrtimi i 4 amendamenteve të deputetes Besa Gaxheri

Kryetari - lexoi amendamentet e propozuara nga deputetja Besa Gaxheri dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet Projekti “Kanalizimi në fshatin Raushiq, Pejë”, në shumën prej 77,000 euro. Amendamenti i deputetes Besa Gaxheri rekomandohet të tërhiqet.
2. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, në projektin me kod 14710, “Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Pejës”, shuma prej 251,279 euro, ndryshohet në shumën 649,530 euro. Amendamenti i deputetes Besa Gaxheri rekomandohet të tërhiqet.
3. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Përkrahje Institucionale për Kulturën”, me kod 80300, në tabelën 3.2., në Projektin me kod 15106 “Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Viti”, shuma prej 50,000 euro, ndryshohet në shumën 188,606 euro. Amendamenti i deputetes Besa Gaxheri rekomandohet të tërhiqet.
4. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Besa Gaxheri që për Grupin Jo formal i Deputeteve të Kuvendit të Kosovës që të krijohet një kod buxhetor dhe për këtë viti ndahen 100.000 euro për këtë qëllim.

1.2.25. Shqyrtimi i amendamentit të deputetëve Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj dhe Arben Gashi

Kryetari- theksoi se amendamenti i propozuara nga katër deputetët, parasheh që në tabelën buxhetore 3.1, buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tek kategoria e pensioneve ‘kontribut paguese të moshës’ të shtohet teksti, përfshirë pensionistët kontributdhënës për vitet 1989-1999, si punëtorët e arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerët që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu amendamentin e propozuar nga deputetët Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj dhe Arben Gashi.

1.2.26. Shqyrtimi i 2 amendamenteve të deputetit Armend Zemaj

Kryetari - lexoi amendamentet e propozuara nga deputeti Armend Zemaj dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës, rruga “Turbis”, lagjja e re në Komunën e Junikut”, në shumën prej 100,000 euro. Amendamenti i deputetit Armend Zemaj, rekomandohet të tërhiqet.
2. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetit Armend Zemaj, që në organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës” me kod organizativ 42100, kategoria “Ndërtimi i Rrugëve të reja, Nënprogrami “Projektet e bashkëfinancimit me kuvendet komunale me kod 42100 në tabelën 3.2, në kategorinë e shpenzimeve kapitale, shtohet projekti i ri me kod 0452 “Asfaltimi i Rrugëve të reja”. Rruga “Can Tishukaj” lidhja Isniq-Lebushë, rruga” Patriot Berisha, AliUkaj dhe AvniPergjegjaj” nëLumbardh, rruga “Drumi i Telit “ Strelle i Ulët, Strelle i Epërm – Lubeniq, rruga “Curraj, Krasniq, Istrefaj, Ukaj”, Strelle i Epërm, në shumën prej 200.000 mijë eurove. Mjetet merren nga kodi 0443, Rehabilitimi i rrugëve rajonale shuma prej 10.000.000 euro ndryshohet në 9.800.000 euro.

1.2.27. Shqyrtimi i amendamentit të deputetëve Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku

Kryetari - lexoi amendamentin e propozuar nga deputetët Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Tregtisë dhe Industrisë”, me kod organizativ 204, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, në tabelën 3.2., në kategorinë e shpenzimeve kapitale, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i Parkut të biznesit në zonën ekonomike në Vushtrri”, në shumë prej 400,000 euro në vitin 2018. Në vitin 2019 shtohen 400,000 euro dhe në vitin 2020 shtohen 400,000 euro. Amendamenti i propozuara nga deputetët Vjosa Osmani dhe Lumir Abdixhiku, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.28. Shqyrtimi i amendamentit të deputetëve Armend Zemaj dhe Besa Gaxherri

Kryetari - lexoi amendamentin e propozuar nga deputetët Armend Zemaj dhe Besa Gaxherri dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Në Organizatën Buxhetore “Ministrisa e Kultrës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Mbrojtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”, me kod 81500, në tabelën 3.2., në projektin me kod 15386 “Restaurimi dhe Konservimi i Kullës “Fazli Boqollit”, Raushiq,

Pejë”, shuma prej 30,000 euro, ndryshohet në shumën 100,000 euro. Amendamenti i propozuar nga deputetët Armend Zemaj dhe Besa Gaxherri, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.29. Shqyrtimi i amendamentit të deputetve Armend Zemaj dhe Lumir Abdixhiku

Kryetari - lexoi amendamentin e propozuar nga deputetët Armend Zemaj dhe Lumir Abdixhiku dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Mbrotjtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”, me kod 81500, në tabelën 3.2., shtohet projekti i ri “Ndërtimi i muzeut të Luftës, Oda e fshatit Lubeniq, Pejë”, në shumë prej 100,000 euro. Amendamenti i propozuar nga deputetët Armend Zemaj dhe Lumir Abdixhiku, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.30. Shqyrtimi i 5 amendamenteve të deputetes Mirjeta Kalludra

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga deputetes Mirjeta Kalludra dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i qerdhës në lagjen Arbëria, Klinë”, në shumë prej 150.000 euro për vitin 2018. Si dhe për vitin 2019 shtohet shuma prej 100,000 euro. Amendamenti i deputetes Mirejta Kalludra, rekomandohet të tërhiqet.
2. Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, me kod 42100, shtohet Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës Përcevë – Sferkë, Klinë”, në shumë prej 300,000 euro. Amendamenti i deputetes Mirejta Kalludra, rekomandohet të tërhiqet.
3. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Mirjeta Kalludra, që në Ministrinë e Infrastrukturës për ndërtimet e reja të rrugëve në Kodin e programit 205070-1730211, Kodin e Projektit 15085 për vitin 2018 të ndahet mjete shtesë në vlerë prej 1,500,000 € për fillimin e Ndërtimit të Rrugës Transit në Klinë (nga N9 - deri në R-104 Klinë - Gjurakovc). Kurse në planifikimin e buxhetit për vitin 2019 të planifikohen mjete shtesë në vlerë prej 800,000 € për përfundimin e ndërtimit të kësaj rruge.
4. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Mirjeta Kalludra, që në Komunën e Klinës për vitin 2018 të ndahet buxhet shtesë në vlerë prej 500,000 € për fazën e parë Ndërtimin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza –Klinë. Ne kërkojmë që të ndahet mjete shtesë në kodin e programit 634660-1832364, Kodin e Projektit 47243 kurse pjesën tjetër të mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me donatorët.
5. Komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Mirjeta Kalludra, që për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Investimeve kapitale në Arsimin para universitar në Kodin e programit 208111-1728370, Kodin e Projektit 15264 për vitin 2018 të ndahen mjete shtesë në vlerë prej 800 000 € nga 750, 000 € sa janë parapare për vitin 2018 pra totali i mjeteve të ndahet për vitin 2018 1,550,000 € për Ndërtimin e shkollës fillore „Ismet Raci” në komunën e Klinës.

1.2.31. Shqyrtimi i 2 amendamenteve të deputetit Mërgim Lushtaku

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga deputetes Mërgim Lushtaku, pas arsyetimit të tyre nga deputeti Mërgim Lushtaku, dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, në nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore dhe sportive “Drenica”, në fshatin Polac, Skenderaj”, në shumë prej 200,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohet shuma prej 250,000 euro. Amendamenti i deputetit Mërgim Lushtaku, rekomandohet të tërhiqet.
2. Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, në nën-programin “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar”, në tabelën 3.2. me kod 98100, shtohet Projekti i ri “Ndërtimi i shkollës së mesme Hamzë Jashari, Skenderaj”, në shumë prej 400,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohet shuma prej 400,000 euro, Amendamenti i deputetit Mërgim Lushtaku, rekomandohet të tërhiqet.

1.2.32. Shqyrtimi i 7 amendamenteve të Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencinë Kundër Korrupsionit

Kryetari – lexoi amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen Agjencinë Kundër Korrupsionit, pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit dhe marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu 7 amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencinë Kundër Korrupsionit.

1.2.33. Shqyrtimi i amendamentit të deputetit Nait Hasani

Kryetari – theksoi se amendamenti i deputetit Hasani parasheh të ndahen mjetet për projektin “shtrimi i rrugës Krushë e Madhe – Randobravë, 2 km, në Prizren. Nuk është përmendur ndonjë shumë.

Ministri – mbështesim amendamentin, dhe të shtohet shuma 300,000 euro. Amendamenti nuk i plotëson kushtet teknike, duhet tërhequr dhe të kalojë si amendament i komisionit.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Ndërtimet e reja të rrugëve”, në tabelën 3.2., me kod 42100, shtohet projekti i ri “Shtrimi i rrugës Krushë e Madhe – Randobravë, 2 km, Prizren” , në shumë prej 300,000 euro. Amendamenti i deputetit Nait Hasani, duhet tërhequr për shkak se nuk i plotëson kushtet teknike.

1.2.34. Shqyrtimi i 7 amendamenteve të Grupit Parlamentar të LDK-së

Kryetari - lexoi amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe pas marrjes së mendimit të ministrit, konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu 7 amendamentet e propozuara nga Grupit Parlamentar i LDK-së.

1.2.35. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Presidentit

Kryetari – Zyra e Presidentit ka kërkuar që në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, të ndahet shuma prej 300,000 euro të cilat do përdoren për konsulentë të jashtme ligjore në mbështetjen e punës së Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.

Ministri – e mbështesim kërkesën.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Presidentit”, me kod organizativ 102, në tabelën 3.1., nën-programi “Zyra e Presidentit”, me kod 10500, në kategorinë e shpenzimeve “mallra dhe shërbime”, ndahet shuma prej 300,000 euro.

1.2.36. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Kryetari – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kërkon buxhet për angazhimin e 13 rojtarëve të rregullt të natyrës në Parkun Kombëtar ‘Sharri’.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

1.2.37. Shqyrtimi i kërkesës për ndarjen e mjeteve buxhetore për trajtimin e qeneve endacak

Safete Hadërgjonaj - Është mirë që ta zgjedhimin problemin e qenëve endacak, dhe nëse e marrim seriozisht këtë çështje dhe e shqyrtojmë atëherë do të kemi përkrahje financiare nga jashtë.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Në Organizatën Buxhetore “Zyra e Kryeministrit”, me kod organizativ 104, në tabelën 3.1., bëhen ndryshimet me tekstin si në vijim: Nën-programi “Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës”, me kod 40800, në kategorinë e shpenzimeve “mallra dhe shërbime”, ndahet shuma prej 900,000 euro për trajtimin e qenëve endacak.

1.2.37 Rishqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryetari – në takimin e grupit punues, kemi lënë të hapur për diskutim çështjen e buxhetit për stafin mbështetës politik. Ne kemi pasur një kërkesë ku na është kërkuar 14 vende të lira pune për këshilltar për Grupet Parlamentare në Kuvend. Pas analizimit të pagës së këtyre këshilltarëve bashkë me Ministrinë e Financave erdhëm në përgjigje që paga mujore e këshilltarëve ishte 2,000 euro rroga, dhe ne menduam që t’iu ndërrohet pozita prej këshilltarit në asistent.

Sekretari – në bazë të kërkesës së komisionit ne kemi kalkuluar pagat për asistent të Grupeve Parlamentare e cila do të jenë bruto prej 800 euro bruto në muaj, përfshirë bonuset. Ndërsa tek mallrat dhe shërbimet është paraparë një shumë prej 100,000 euro. Duhet të them edhe një gjë nëse formohet edhe një Grup i Ri Parlamentar atëherë na duhet një buxhet prej 300,000 mijë euro.

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Në Organizatën buxhetore “Kuvendi i Kosovës”, me kod organizativ 101, bëhen ndryshimet si në vijim:
 - 1.1. Nënprogrami “Stafi mbështetës politik”, me kod 15800, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve “numri i të punësuarve”, nga 46, ndryshohet në 60.
 - 1.2. Nënprogrami “Stafi mbështetës politik”, me kod 15800, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve “paga dhe mëditjet”, shuma prej 600,031 euro, ndryshohet në shumën 856,031 euro.
 - 1.3. Nënprogrami “Stafi mbështetës politik”, me kod 15800, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve “mallra dhe shërbime”, shuma prej 90,000 euro, ndryshohet në shumën 130,000 euro.

1.3. Shqyrtimi i pjesës tekstuale të Projektligjit për Buxhetin të Republikës së Kosovës 2018

Lulzim Rafuna - në bazë të autorizimit të Ministrisë të Financave po i lexoj propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e pjesës tekstuale të buxhetit si në vijim: kemi një kërkesë prej Zyrës së përfaqësive së Komisionit Evropian në Kosovë që të futet paragrafi që ka qenë në ligjin e buxhetit të vitit të kaluar të vitit 2016 ku e ka treguar burimet e të hyrave që lidhen me doganat në dy pikat doganore të pjesës veriore të vendit. Propozimi konkret është që nenin 11, të shtohet paragrafi 3 me tekstin si në vijim:

“Të gjitha paratë publike të mbledhura nga mallrat e importuara nga bizneset e regjistruara në Mitrovicën Veriore, Zubin Potok, Leposaviq apo Zveçan, të cilat janë të destinuara për konsum në këto komuna të dokumentuara përmes dokumenteve përkatëse, në momentin e hyrjes në Kosovë përmes pikave doganore në Jarinjë (pika 1) ose Bërnjak (pika 31) duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht në SIMFK, dhe ndahen për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit i krijuar nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë në Bankë Komerciale të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.”

Kryetari konstatoi se Komisionit miratoi propozimin e Ministrisë së Financave dhe propozojë amendamentin që në nenin 11, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, me tekstin si në vijim:

3. Të gjitha paratë publike të mbledhura nga mallrat e importuara nga bizneset e regjistruara në Mitrovicën Veriore, Zubin Potok, Leposaviq apo Zveçan, të cilat janë të destinuara për konsum në këto komuna të dokumentuara përmes dokumenteve përkatëse, në momentin e hyrjes në Kosovë përmes pikave doganore në Jarinjë (pika 1) ose Bërnjak (pika 31) duhet të dërgohen në Fondin e Kosovës duke u identifikuar dhe regjistruar veçanërisht në SIMFK, dhe ndahen për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit i

krijuar nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë në Bankë Komerciale të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Lulzim Rafuna - propozimi tjetër është që në nenin 12, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, fjalët “ndaj tyre”, zëvendësohen me fjalët “ndaj personave përgjegjës”

Kryetari konstatoi se Komisionit miratoi propozimin e Ministrisë së Financave dhe propozon amendamentin që në nenin 12, në paragrafin 1, në rreshtin e pestë, fjalët “ndaj tyre”, zëvendësohen me fjalët “ndaj personave përgjegjës”

Lulzim Rafuna - në nenin 13, mendojë që paragrafi 3 të korrigjohet ku thuhet që Qeveria kërkon rekomandimin nga Komisioni për miratimin e buxhetit dhe financave për dhënien e paradhënies deri 100%. Ky pjesë të riformulohet ‘të merret ose të kontraktohet për mallrat dhe shërbimet’.

Naser Osmani – mendojë që ndoshta nuk duhet të figurojë fare konsultimi i Qeverisë me Komisionin për Buxhet dhe Financa, pasi që çështja e paradhënies është e rregulluar dhe duhet trajtuar sipas ligjit në fuqi.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisionit propozoi amendamentin që në nenin 13, paragrafi 3, në rreshtin e tretë fshihet teksti “vetëm pas rekomandimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të Kuvendit”

Lulzim Rafuna - propozimi tjetër është që në nenin 15, pas paragrafit 1 të shtohet paragrafi 2, me tekstin si në vijim: Ministri i Financave mund të bëjë ndarjen e mjeteve të parapara në Ministrinë e Financave, nënprogrami “Kontigjencat në Ministrinë e Financave”, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.

Kryetari konstatoi se Komisionit miratoi propozimin e Ministrisë së Financave dhe propozojë amendamentin që në nenin 15, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2, me tekstin si në vijim: “Ministri i Financave mund të bëjë ndarjen e mjeteve të parapara në Ministrinë e Financave, nënprogrami “Kontigjencat në Ministrinë e Financave”, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfero.”

Kryetari – me qëllim të rregullimit gjuhësor propozojë që në nenin 19, paragrafi 2, në rreshtin parë, pas fjalës “të këtij neni”, të shtohet fjala “mund të bëhet”.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni miratoi propozimin që në nenin 19, paragrafi 2, rreshti parë, pas fjalës “të këtij neni”, shtohet fjala “mund të bëhet”

Mbledhja përfundoi në ora 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku